

SPECIFIKIME TEKNIKE

**Objekti : “REHABILITIM I SHESHEVE, GODINAVE
DHE QENDRES SE QYTETIT”**

Bashkia HAS

Autor i Projektit

“ERALD - G” shpk

2016

A-1 PRISHJET NE OBJEKTET E RIKONSTRUKSIONIT

PRISHJA E SUVATIMIT EKZISTUES NE FASADA

Ne rikonstrukcionin e fasadave, nje pjese e objektit paraqet nevojen per prishjen e pjesshme te shtreses se suvatimit ekzistues. Kjo vjen si pasoje e gjendjes se renduar ne te cilen eshte objekti ekzistues. Ky proces (prishje-rindertim i suvase) eshte analizuar per objekte te vecanta te cilat jane caktuar ne vend nga grupi projektimit. Per objektet e specifikuara per kete nderhyrje eshte caktuar nje siperfaqe e vecante e ri-suvatimit e cila eshte futur ne preventiv.

Procedura e vleresimit te suvatimit ekzistues eshte bere nga grupi i projektimit. Gjate zbatimit te punimeve, firma, duhet te bashkepunoje projektusit dhe me bashkine per percaktimin e ketyre objekteve ne terren.



Fig.1.Foto e gjendjes ekzistuese - Shembull

SPECIFIKIME TEKNIKE
“REHABILITIM I SHESHEVE, GODINAVE DHE QENDRES SE QYTETIT”



Fig.2.Foto e gjendjes ekzistuese - Shembull

SPECIFIKIME TEKNIKE
“REHABILITIM I SHESHEVE, GODINAVE DHE QENDRES SE QYTETIT”

RIPARIMI I KORNIZAVE MBYLLESE TE OBJEKTEVE

Ky proces perfshin heqjen e kornizave te demtuara dhe zevendesimin e tyre sipas modelit ekzistues ne beton te parapregatitur ku taracat jane me cati druri. Ne rast se gjendja ekzistuese e tyre pranon rikonstrukcion me suvatim, atehere te behet zgjidhja duke u konsultuar me projektuesit.



Fig.3.Foto e gjendjes ekzistuese – Shembull

Shënim:Mund te lihet e hapur si klauzole, sipas nevojës se banoreve, gjate kohës qe behet riparimi, ose ndertimi i parapetit te ri dhe vendosja e izolimit te ri, mund te ndertohet me kontribut te banoreve midis tyre, i gjithe izolimi i ri i taraces. Kjo ngelet per tu caktuar nga supervizori i punimeve.

HEQJA E ULLUKEVE HORIZONTAL E VERTIKAL

Ne projekt eshte parashikuar heqja e ullukeve vertikal dhe horizontal te shakrkimit te ujerave te shiut se bashku me kasetat. Ne te gjitha rastet ku keto kasete dhe ulluke ekzitues jane te demtuar, te hequr. Ato duhet te zevendesohen me ulluke te rinj xingato, ashtu si jane parashikuar ne preventiv.

Vendosja dhe fiksimi i tyre duhet te behet nga specialiste me pervojte sepse keto jane procese pune delikate te cilat kerkojne vemdje dhe kujdes te vecante. Kujdes duhet ti kushtohet dhe fiksimit te ullukeve vertikal ne muret e tulles dhe lidhja, bashkimi i tyre me njeri tjetrin.



Fig.10.Foto e gjendjes ekzistuese – Shembull

HEQJA DHE TRANSPORTIMI I MATERIALEVE TË PAPËRDORSHME

Ngarkimi, transportimi i mbetjeve do të thotë që materialet që ngelen nga heqjet e ullukeve, prishjet, etj, të largohen nga kantjeri duke përfshirë dhe shkarkimin e tyre.

A-2 PUNIME MURATURE

PARAPET I JASHTËM TULLE (TIP 12.5)

Murature me lartesi rreth 1.5-2m ne varesi te vendndodhjes duhet percaktuar ne fakt per realizimin e oxhaqeve dhe te realizohet me llaç bastard m-20, me përmbajtje për m³: gjysem tulla nr.400, llaç bastard m³ 0.25, çimento 400, për çdo trashësi muri, duke përfshirë çdo detaj dhe kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, parmakët, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj.

Vendosja e tullave:

- a) Muret duhet ngritur në mënyrë të rregullt. Punimi që është lënë në disnivele të ndryshme nuk do të pranohet.
- b) Rradhët e tullave duhet të nivelohen siç duhet. Këndet e qosheve të vihen në plumbçe siç duhet.
- c) Të gjitha muret duhet të jenë të lidhur (vendosur) në përputhje me praktikën me kushtet teknike KTZ.
- d) Të gjitha tullat duhet të zhyten në ujë, para se të përdoren në vend . Faqet e mureve duhet të mbahen të pastër dhe pa llaç apo pika të tij.
- e) Të gjitha tullat duhen mbuluar mirë me llaç përpara se të shtrihet rreshti pasardhës dhe të gjitha fugat duhet të jenë të mbyllura dhe të qëndrueshme në të gjithë trashësinë e murit të një rreshti.
- f) Muret që do të suvatohen t'i kenë fugat horizontale të pambushura në një thellësi prej 15 mm.

A-3 PUNIME SUVATIMI

SUVATIMI I JASHTËM NË RIKONSTRUKSIONE

Ky punim do të konsistojë në furnizimin e të gjithë materialeve të çimentos dhe llaçit, dhe kryerjen e punimit në përputhje me Vizatimet dhe Specifikimet.

MATERIALET

- a) Çimentoja, uji , rëra dhe çdo aditivi i përdorur, duhet të përputhet me të një njëjtat kërkesat si dhe seksioni 3 i këtyre specifikimeve (punimet e betonit). Aditivet, sipas Standartit Britanik – BS 5075, ASTM C 260 C 494.
- b) Rëra e përdorur për spruco dhe për shtresën e parë të suvasë duhet të jetë me granulometri uniforme dhe të kalojë në sitën No.4 dhe të mbahet në sitën No.5.
- c) Rëra e përdorur për shtresën e dytë duhet të jetë rërë e imët që kalon e gjitha në sitën No.5 (2.38 mm.) dhe mbetet në sitën No.8 (.30 mm).

MËNYRA E PËRDORIMIT

- a) E gjithë suvaja duhet të bëhet në një mënyrë sa më të pastër dhe të rregullt. Të gjitha faqet, përveç atyre të kurbëzuara duhet të jenë të rrafshta, dhe të sakta, dhe këndet duhet të jenë të drejta dhe në nivel ose plumçe dhe lehtësisht të rumbullakosura deri në 5 mm. Mund të vendoset edhe sferë në qoshe nëse duhet.
- b) Të gjitha veglat, mjetet e punës, enët dhe sipërfaqet duhet të mbahen në çdo kohë në mënyrë strikte të pastra dhe masa paraprake duhet të merren për të parandaluar që suvaja ose material tjetër të bëhet pis nga copra ose material i ngurtësuar i cili tenton të ngadalësojë ngurtësimin ose përshpejton atë.
- c) Suvatimi duhet të bëhet me kujdes dhe mjaft i mirë afër dritareve, carjeve të ballkoneve në forme llozhe apo metalit dhe përreth tubave dhe aksesorëve. Kontraktori duhet të ndjekë dhe të riparojë çdo vend pas vendosjes së ndonjë paisjeje.

PËRGATITJA

Të gjitha sipërfaqet që do të suvatohen duhet të jenë të pastra dhe pa pluhur, material të shkruftë dhe pa prani të kripëzimit. Llaçi i rënë mbi sipërfaqe dhe i tharë apo beton duhet të hiqet me çukitje. Gjurmë të vajit të kallëpëve, grasos, pluhurit dhe çdo material tjetër të panevojshëm duhet të hiqen me anë të fërkimit me ujë dhe detergjent.

Kur do të përdoret llaç çimento, sipërfaqet duhet së pari të njomen me ujë dhe të bëhen me spruco siç përshkruhet më poshtë.

SUVATIMI I JASHTËM

Suvatimi i jashtëm do të konsistojë në dy shtresa (përveç shtresës së sprucës së përmendur më lart) që ka një trashësi totale prej afërsisht 20 mm. Si vijon:

a) Shtresa e parë do të jetë 14-16 mm e trashë e përbërë nga një llaç çimento ne raporte 1:4 (një pjesë çimento dhe katër pjesë rëre të trashë me granulometri uniformë) dhe duhet bërë midis dy fashaturave jo më larg se 2 m njëra nga tjetra dhe duhet të punohet me mallë, të jetë e rrafshët dhe në plumçë, pa vrima dhe pa gërvishje, apo parregullsi.

Kjo shtresë duhet të bëhet me vija kryq e tërthor për të lejuar një kapje më të mirë të shtresës së dytë, dhe të lihet të thahet për tre ditë, periudhë gjatë së cilës duhet të ngurtësohet dhe të mbahet e lagur në mënyrë të vazhdueshme

b) Shtresa e dytë do të jetë një rrjetë plastike e cila do të vendoset në kuotat e solaetave të kateve në trashësinë e soletës dhe +10cm më shumë sipër dhe poshtë fashës së soletës së objekteve që do të rikonstruktohen duke bërë të mundur lidhjen me të mirë të shtresës së sipërme të suvase me muraturnë.

c) Shtresa e tretë dhe përfundimtare do të ketë një trashësi 3-4 mm dhe do të jetë suva e thjeshtë. Ky material do të përdoret sipas udhëzimeve të prodhuesit. Suvaja do të jetë e materialit më të mirë.

Suvaja do të realizohet në vend sipas gjendjes ekzistuese të objektit, duke ruajtur çdo karakteristike arkitektonike të tij.

d) Element tjetër i rëndësishëm që do të realizohet me anë të suvatimit, janë kornizat e dritareve të parapeteve të ballkoneve si edhe kornizave mbyllesë të objekteve ku ka nevojë. Pozicionimi i tyre, dimensionimi dhe ngjyra të ndiqet sipas projektit. Trashësia e daljes së këtyre kornizave nga niveli i muraturnës do të bëhet duke ndjekur gjendjen autentike.

Një kornizë që do të ndërtohet me suva është edhe ajo që do të ndaje ngjyren e suvase midis kateve përdehe të objekteve (me funksion kryesisht tregtar) dhe atyre të sipërme.

e) Përcaktimi i ngjyrave të suvase do të bëhet nga projektuesi në bashkëpunim me supervizorin

Shënim:

SPECIFIKIME TEKNIKE
“REHABILITIM I SHESHEVE, GODINAVE DHE QENDRES SE QYTETIT”

Nje pjese e objekteve kane suvatime te nisura ne menyre privatenga banore. Keto pjese te objektit do te jete edhe pjese e zbatimit te ketij projekti, per te pasur rezultat te njejte me te gjitha objektet e tjera te marra ne studim. Fazat e suvatimit dhe detajeve te tjera te zbatimit te projektit do te ndiqen nga supervizori.

LYERJA ME BOJE E FASADES.

Perpara se te behet lysterja me boje e fasades, kur suvatimi eshte i mire e nuk ka nevojte per riparime siperfaqja e fasades duhet te stukohet, pastrohhet dhe te lyhet me astar. Mbas tharjes se astarit behet lysterja me boje sipas ngjyres se dhene nga projektuesit.

Ne ratin kur suvatimi ne fasade eshte i ri, suvatimi duhet te thahet te behen stukimet e nevojshme per cdo rast dhe pastaj siperfaqja lyhet me astar e pastaj me boje. Ne snje rast nuk lejohet perzierja e dy ose disa llojeve te ndryshme markash boje me suvane.

NDERTIMI I CATIVE.

Ndertimi i cative do te jete me tulla vendi dhe me pjerresi 30 grade sic eshte percaktuar dhe ne fletet e vizatimit. Ndertimi i cative do te behet njekohesisht me ndertimin e oxhaqeve, me lende drusore dhe kapriata druri. Fazat e detajeve per ndertimin e cative do te ndiqen nga supervizori.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

SPECIFIKIME TEKNIKE
“REHABILITIM I SHESHEVE, GODINAVE DHE QENDRES SE QYTETIT”

- ❖ Suvatimi në kohë të lagur nuk do të lejohet, po ashtu kur sipërfaqja që do të suvatohet të jetë me pluhur.
- ❖ Të gjitha shtresat e lyerjes me emulsion duhet të jenë tërësisht të thata para se shtresa të tjera të aplikohen.
- ❖ Të gjitha suvatimet duhen bërë në përputhje strikte me specifikimet dhe instruksionet e prodhuesit.
- ❖ Të gjitha materialet suvatimit duhet të aplikohen në përputhje me udhëzimet e shkruara të prodhuesit.
- ❖ Të merren të gjithë masat paraprake që të mbahet pluhuri poshtë para dhe gjatë procesit të suvatimit. Asnjë suvatim nuk duhet të aplikohet në sipërfaqe strukturale apo sipërfaqësore të lagura, dhe të gjitha sipërfaqet duhet të sigurohen se janë të lira nga kondensimi, avulli, etj, para se të fillojë procesi.
- ❖ Sipërfaqe të prajmuara metalike apo druri nuk duhen lënë të pambrojtura dhe në situata të ekspozuara për një periudhë të papërshtatshme para se të kryhet kompletimi i projektit. Asnjë suvatim nuk duhet bërë në kushte moti me shi, lagështirë të tepërt apo me ngritjes pluhuri, etj.
- ❖ Kontraktorit do t’i kërkohet të ribeje me shpenzimet e tij çdo punim cili gjendet të jetë bërë në mënyrë jo korrekte. Kontraktori duhet të jetë përgjegjës për mbrojtjen nga dëmtimi të suvase dhe çdo lloj punimi tjetër gjatë operacionit të suvatimit, duke siguruar çdo panel mbrojtës për pluhurin, mbulesa etj.
- ❖ Furçat, shishet, penet etj të përdorur në kryerjen e punimit duhet të jenë të pastër dhe pa asnjë material të huaj. Ato duhen pastuar tërësisht para se të përdoren për tipe dhe klasa të ndryshme materialesh.
- ❖ Bojrat që do të vendosen për zbatimin e projektit duhet të behen nga një prodhues me eksperience në këtë fushë. Nuk lejohet perzierja e dy ose disa llojeve të ndryshme markash boje me suvane.
- ❖ Materiali duhet të merret nga prodhues të aprovuar dhe duhet të sillet në enët e prodhimit të vulosura të pahapura.
- ❖ Eshtë e domosdoshme që pajisjet ose mobilje që janë të mbështetura ose të varura në mur si tabela reklamash, kondicionera, etj, të largohen në mënyrë që të behet një suvatim i plote i objektit.
- ❖ Personeli që do të punojë me këtë projekt duhet të ketë eksperience në këtë fushë si dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike sipas KTZ dhe STASH.